



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MIRDITË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 840/1 Prot

Rrëshen, më 26.03.2026

V E N D I M

Nr. 19 datë 19. 03. 2026

PËR
“MIRATIMIN E ANEKSEVE TË MONITORIMIT, TË BUXHETIT TË VITIT 2025”,
BASHKIA MIRDITË

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015", Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, në ligjin nr.68/2017, pika 3, neni 48, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligjin nr. 115/2024, “Për buxhetin e vitit 2025”, Udhëzimin nr. 9, datë 20. 07. 2018, i Ministrisë Financave dhe Ekonomisë, “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, në Udhëzimin nr. 22, datë 30. 07. 2018 “Për procedurat standarte të monitorimit të buxhetit të njësisve të vetëqeverisjes vendore”, pika 48, dhe formateve të aneksit 1 dhe 2, bashkëlidhur, në Vendimin nr. 115, datë 27.12.2024, të Këshillit Bashkiak Mirditë, “Për miratimin e buxhetit të vitit 2025”, Vendimin nr. 20, datë 24.02.2025, të Këshillit Bashkiak Mirditë, “Për miratimin e fondeve të trashëguara nga buxheti i vitit 2024”, *Analiza e realizimit të shpenzimeve dhe të ardhurave të vitit 2025, Bashkia Mirditë; (nr. 839 prot, datë 18.02.2026)*, së bashku me projekt-vendimin e paraqitur nga Kryetari i Bashkisë, *shqyrtimin e miratimit, në mbledhjen e datës 18.03.2026, të Komisionit Ekonomisë, Financës dhe Buxhetit*, për t’a kaluar në mbledhjen e Këshillit Bashkiak, pas diskutimeve;

V E N D O S I:

1. Të miratojë anekset e monitorimit të buxhetit të vitit 2025, Bashkia Mirditë, *(bashkëlidhur, Analiza e realizimit të shpenzimeve dhe të ardhurave të vitit 2025, Bashkia Mirditë; (nr. 839 prot, datë 18.02.2026) dhe tabelat, pjesë përbërse e këtij vendimi)*
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë, (Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Tatim Taksave)

Ky vendim, hyn në fuqi, sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” të ndryshuar, dhe pas konfirmimit ligjor, nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Lezhë.

SEKRETAR

Gaspër TOPOLLAJ



ADRESA: SHESH I ABAT DOCI, RRËSHEN

KRYETAR

Aleksandër PİÇAKU



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PREFEKTI I QARKUT LEZHË
SEKTORI JURIDIK



Nr. 840/2 Prot

Dt. 03.04.26

Nr. 310/4 Prot.

Lezhë, më 01.04.2026

Lënda: Konfirmim vendimi

KËSHILLIT TË BASHKISË MIRDITË

Për Dijeni : KRYETARIT TË BASHKISË MIRDITË

Bazuar në nenin 16 pika 2 gërma "b" të ligjit Nr.107/2016, datë 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", i ndryshuar ligjin nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar, ligjin nr.68, datë 27.04.2017 "Për financat e Vetëqeverisjes Vendore", ligjin nr.9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Ligjin nr.115/2024 "Për buxhetin e vitit 2025," në Udhëzimin e Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave nr.9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", në Udhëzimin nr.22, datë 30.07.2018, "Për procedurat standarte të monitorimit të buxhetit të njëjësive të vetëqeverisjes vendore", konfirmoj bazueshmërinë ligjore të vendimit nr.19, datë 19.03.2026 të Këshillit të Bashkisë Mirditë "Për miratimin e anekseve të monitorimit, të buxhetit të vitit 2025", bashkia Mirditë.

PREFEKTI

Taulant MALSHI

